



PARTNERËT-SHQIPERI
QENDRA PËR NDRYSHIM
DHE MANAXHIM KONFLIKTI

raport dy vjeçar

1 tetor 2006
30 shtator 2008





PARTNERET-SHQIPERI
QENDRA PËR NDRYSHIM
DHE MANAXHIM KONFLIKTI

RAPORT DY VJEÇAR

1 Tetor 2006 – 30 Shtator 2008

PARTNERËT-SHQIPËRI

QENDRA PËR NDRYSHIM DHE MANAXHIM KONFLIKTI

Rruga Muhamet Gjollështa, Pall. 16/1, Hyrja 1, Ap.9,
Tiranë, Shqipëri ose Kutia Postare 2418/1,
Posta Qendrore Tiranë.

Tel: 00355 42 254881 / 254883

Faks: 00355 42 254883

partners@partnersalbania.org

www.partnersalbania.org

Tabela e Lëndës

Partnerët-Shqipëri	7
Stafi Ekzekutiv dhe Antarët e Bordit të PSH	7
Mesazh nga Drejtorja e Partnerëve-Shqipëri	8
Fushat Programatike	9
Vështrim i Përgjithshëm	9
Përmbledhje e Aktiviteteve Kryesore	9
Zhvillimi i Sektorit të OJF-ve	13
Programe Trajnimi dhe Asistencë Teknike	13
Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Fushata Advokacie	15
Programi i Granteve të Vogla	17
Kuadri Ligjor i OJF-ve	19
Kodi i Etikës për OJF-të	20
Kontributi në Qeverisjen e Mirë në Nivel Vendor dhe Qendror	21
Trajnime dhe Asistencë Teknike për Stafin e Bashkive	21
Promovimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Qeverisjen Vendore	21
Mbështetja e Transparencës në Qeverisjen Qendrore	22
Eksperiencia Ndërkombetare e Aktiviteteve të PSH	25
Rritja e Kapaciteteve të Qendrës Burimore për Trajnime Advokacie (QBTA), Kosovë	25
Forcimi i Qeverisjes së Mirë në Lindjen e Mesme	25
Partnerët-Shqipëri si Qendër Burimore	26
Publikimet	26
Zhvillimi i Kurrikulës Trajnuese	27
Biblioteka	28
Programi I Internshipit	28
Mbështetësit dhe Bashkëpunëtorët	29
Anekse	30
Pasqyrat Financiare	30
Financuesit dhe Bashkëpunëtorët	32
Përfituesit e Programit të Granteve të Vogla	34

Partnerët - Shqipëri

Partnerët-Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti (PSH) është një OJF e pavarur shqiptare, e regjistruar në gjykatën e Tiranës në Prill 2001. Misioni i saj është të zhvillojë shoqërinë civile dhe një kulturë ndryshimi e manaxhimi konflikti në Shqipëri.

PSH është bërë një udhëheqës kombëtar në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Programi i trajnimeve dhe asistencës teknike të Qendrës krijon aftësi të qëndrueshme në sektorin e shoqërisë civile për përmirësimin e bashkëpunimit me qeverinë dhe sektorët e tjerë. Partnerët-Shqipëri në mënyrë të vazhdueshme kryen vlerësime të kapaciteteve të OJF-ve lokale rreth nevojave të tyre në fushat që përfshijnë advokacinë, anti-korrupsionin dhe qëndrueshmërinë organizative.

Partnerët-Shqipëri, që në themelimin e saj është bërë anëtare e Rrjetit të Partnerëve Ndërkombëtarë për Ndryshim Demokratik, i cili përbëhet nga 18 Qendra të pavarura në Shqipëri, Argjentinë, Bullgari, Kolumbi, Republikën Çeke, Gjeorgji, Hungari, Jordani, Kosovë, Lituani, Meksikë, Peru, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Shtetet e Bashkuara dhe Jemen. Qendrat ofrojnë trajnime dhe shërbime për zgjidhje konfliktesh për aktorë të ndryshëm të sektorit të OJF-ve, qeverisjes qendrore e vendore si dhe sektorit të biznesit në Europën Qendrore e Juglindore, Amerikën Latine dhe Lindjen e Mesme.

Prej Janarit 2006 Partnerët Ndërkombëtarë për Ndryshim Demokratik operon në Bruksel si një organizatë me antarësi.

Stafi Ekzekutiv i PSH

Juliana Hoxha, Drejtore

Raimonda Duka, Manaxhere e Lartë Programi

Jonida Alite, Trajnere/Manaxhere Programi

Arjola Agolli, Trajnere/Manaxhere Programi

Klotilda Tavani, Trajnere/Manaxhere Programi

Arla Gruda, Trajnere/Manaxhere Programi

Shpresa Arbi, Trajnere/Manaxhere Programi

Klodiana Dervishi, Financiere

Elona Kapexhiu, Asistente e Lartë e Grupit Manaxhues

Elona Dini, Asistente Programi

Arben Musaka, Shofer

Anëtarët e Bordit të PSH

Elvana Zhezha, Kryetare Bordi

Shefe Kabineti, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë

Elvis Toçi, Zv. Kryetar;

Përfaqësues i Carrier për Shqipërinë

Klodiana Kapo, Sekretare

Gazetare, Top Channel

Anduela Arbana, Anëtare

Specialiste, Instituti i Monumenteve të Kulturës

Arten Zikaj, Anëtar

Zv. Drejtor, Fondi për Kosovën

Mirjeta Emini, Anëtare

Këshilltare për taksat, Boga & Associates

Pranvera Behushi, Anëtare

Avokate

Mesazh nga Drejtorja e Partnerëve-Shqipëri

Ky është raporti i tretë publik i Partnerëve-Shqipëri që prej krijimit të Qendrës në vitin 2001. Është inkurajuese të shohësh nivelin e përpjekjeve dhe impaktin e arritur në drejtimit kryesore të zhvillimit të sektorit të OJFve dhe në konsolidimin e sistemeve demokratike në vend.

Proceset transparente dhe ulja e korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes kanë qenë në fokusin e punës së Partnerëve gjatë kësaj periudhe. Qëllimi ishte zhvillimi i një qytetarie më të angazhuar dhe i një qeverisjeje vendore e qendrore më të përgjegjshme, në të cilën zyrtarët ndjekin interesin publik e jo përfitimin personal.

Studimet, raportet e monitorimit dhe sondazhet e opinionit publik me fokus transparencën dhe përgjegjshmërinë e insitucioneve qeverisëse në nivel vendor e qendror kanë qenë një tjetër kontribut i Partnerëve – Shqipëri në fushën e proceseve me pjesëmarrje dhe përpjekjeve antikorrupsion.

Zgjedhjet Vendorë të Shkurtit 2007 shënuan një përfshirje domethënëse të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset politike në Shqipëri. Partnerët-Shqipëri ishte një kontribues themelor në organizimin dhe mbështetjen e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, bashkim i nëntë organizatave dhe 2500 vëzhguesve, në monitorimin e procesit parazgjedhor dhe ditës së zgjedhjeve.

Fushata “Unë mbështes qeverisjen e mirë” organizuar nga Partnerët-Shqipëri në shtatë qytete të Shqipërisë ofroi një përqsasje të re në promovimin e qeverisjes së mirë dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje gjatë një viti elektoral.

Një kuadër ligjor mundësues për sektorin e OJF-ve është një tjetër vijim i mbështetjes së Partnerëve-Shqipëri për sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Partnerët përmes një përpjekjeje të koordinuar me sektorin e OJF-ve i'u përgjigjën në mënyrë proaktive disa ndryshimeve ligjore ndërmarrë nga qeveria lidhur me sistemin fiskal.

Kodi i Etikës për OJFtë u prezantua për herë të parë gjatë kësaj periudhe si një përpjekje e vërtetë për të adresuar çështje të transparencës dhe përgjegjshmërisë në sektorin e OJF-ve. Iniciativa u prit me interes dhe u mbështet nga një numër i madh OJF-sh në të gjithë vendin. I mbetet kohës të provojë relevancën dhe efektivitetin e tij në sektorin e OJF-ve.

Partnerët-Shqipëri si antare e Partnerëve Ndërkombëtarë për Ndryshim Demokratik me kënaqësi prezanton zgjerimin e rrjetit në tre vende të tjera me tre Qendra të reja në Serbi, Kolumbi dhe Jemen.

Në Dhjetor 2007 Partnerët-Shqipëri u zhvendos në ambjentet e reja, pronë e tyre, duke e konsideruar këtë si një hap të madh drejt konsolidimit dhe qëndrueshmërisë financiare të organizatës.

Fushat Programatike

Vështrim i Përgjithshëm

Partnerët - Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti prezanton në këtë publikim një seri suksesesh dhe arritjesh për periudhën 2006-2008. Këto arritje vijnë falë përpjekjeve të Qendrës gjatë këtyre dy viteve, angazhimit të stafit të saj kompetent e të konsoliduar, marrëdhënieve të suksesshme me partnerë në gjithë sektorët brenda e jashtë vendit.

Trajnime dhe Asistencë

Rritja e njohurive dhe fuqizimi i kapaciteteve të OJF-ve dhe institucioneve qeveritare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar



Proceset Pjesëmarrëse

Promovimi i bashkëpunimit dhe sigurimi i pjesëmarrjes së komuniteteve të ndryshme në të gjitha nivelet e vendim-marrjes



Studime dhe Vlerësime

Monitorimi i performancës së institucioneve qeveritare në mbështetje të proceseve demokratike



Inkurajimi i Iniciativave Qytetare

Promovimi i mekanizmave advokues që nxisin pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin në mënyrë efektive dhe domethënëse





Kuadri Ligjor i OJF-ve

Kontributi për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor të OJF-ve dhe mekanizmave të tjerë vetërregullues brenda sektorit



Lehtësimit i Proceseve të Zhvillimit Organizativ, Konferencave dhe Takimeve

Ofrimi i asistencës profesionale dhe një metodologjie të avancuar në lehtësimin e proceseve



Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Promovimi i shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave



Zhvillimi i Kurrikulës Trajnuese

Hartimi i programeve trajnuese për sektorë të ndryshëm (shoqëri civile, administratë publike dhe sektor privat)



Biblioteka e PSH-së

Libra, artikuj, raporte, gazeta e publikime të ndryshme mbi çështje të demokracisë e zhvillimit

Përmbledhje e Aktiviteteve Kryesore

Partnerët-Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti vjen në vitin e 8-të të aktivitetit të saj si një qendër e konsoliduar burimore për informacion, trajnim, asistencë teknike dhe studim, për sektorin jo-qeveritar, qeverisjen vendore e qendrore.

Gjatë kësaj periudhe PSH implementoi një seri projektesh dhe iniciativash afatgjata, duke promovuar proceset pjesëmarrëse, hartimin e politikave dhe përpjekjet advokuese për të konsoliduar proceset demokratike e transparencën në Shqipëri.

Zhvillimi i Sektorit të Shoqërisë Civile

Ngritja e kapaciteteve të sektorit të OJF-ve vazhdoi të ishte në fokus të aktivitetit të PSH dhe për periudhën 2006-2008.

Partnerët-Shqipëri hartoi dhe ofroi trajnime e asistencë teknike, mbështeti me grante të vogla OJF-të lokale dhe lehtësoi iniciativa për të përmirësuar transparencën e imazhin e sektorit, si dhe kuadrin ligjor të OJF-ve.

- 34 programe trajnimi u zhvilluan për rreth 552 përfaqësues të organizatave lokale të shoqërisë civile në të gjithë vendin, mbi qeverisjen me pjesëmarrje, lehtësimin e proceseve me pjesëmarrje, përmirësimin e manaxhimit organizativ, politikave dhe procedurave, dhe mobilizimin e komunitetit në proceset zgjedhore.
- 45 organizata të shoqërisë civile u trajnuan e u asistuan për të zhvilluar fushata advokuese të qytetarëve në kuadër të zgjedhjeve vendore të 2007-ës.
- Me mbështetjen e USAID, nëpërmjet Programit për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DQSH), PSH inicioi dhe lehtësoi shtatë fushata lokale nën sloganin “Unë mbështes qeverisjen e mirë” në Korçë, Pogradec, Shkodër, Vlorë, Durrës, Gjirokastër e Fier, duke promovuar kështu mekanizma të një qeverisjeje të mire dhe duke rritur përgjegjshmërinë e liderëve të zgjedhur vendorë.
- PSH si pjesë e programit DQSH

mobilizoi dhe mbështeti “Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë” të përbërë nga nëntë OJF lokale, në të cilin u mobilizuan 3300 vëzhgues vendorë për të monitoruar 2301 qendra votimi, në 65 bashki, 53 komuna dhe 340 qendra numërimi në të gjithë Shqipërinë, duke mbuluar kështu 100% të bashkive dhe 18% të komunave të vendit.

- 10 organizata lokale të shoqërisë civile në Kukës, Shkodër, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Pogradec u asistuan në hartimin e planeve strategjike afatgjata.
- 25 OJF u mbështetën financiarisht nga Fondi i Granteve të Vogla të programit DQSH.
- Për herë të parë u hartua dhe aprovua në parim Kodi i Etikës së OJF-ve si një mjet për të promovuar transparencën brenda sektorit.
- PSH lehtësoi një seri takimesh me përfaqësues të OJF-ve lidhur me legjislacionin fiskal që efektikon sektorin dhe udhëhoqi përpjekje lobuese për të propozuar ndryshime ligjore në nivel qeverie e parlamenti.
- 28 përfaqësues të organizatave lokale të shoqërisë civile, trajnerë dhe drejtues të OJF-ve në Jordani u trajnuan në Qeverisje të Mirë, Transparencë, Përgjegjshmëri dhe Mobilizim Qytetar në Jetën Politike.
- U forcuan kapacitetet e stafit lokal të Qendrës Burimore për Trajnime Advokacie (QBTA) në Kosovë, nëpërmjet një programi trainimi dhe asistence tetë mujore në rishikimin e moduleve dhe manaxhimit e granteve.
- U publikua edicioni i tretë i “Adresarit të OJF-ve Shqiptare” i cili ofron një njohje më të plotë të sektorit të OJF-ve në Shqipëri.
- U publikua Advokacia dhe Zgjedhjet Vendore, Eksperiencia Shqiptare në 2007-Udhëzuesi i Praktikave më të Mira, për të theksuar eksperiencën e OJF-ve gjatë procesit të Zgjedhjeve Vendore 2007.
- U publikua Manaxhimi Financiar i OJF-ve, Koncepte Bazë, një guidë që u vjen në ndihmë manaxherëve dhe financierëve të OJF-ve të kuptojnë konceptet bazë të manaxhimit financiar si sistemet e kontabilitetit dhe të raportimit, kontrollet e brendshme, procesin e buxhetimit, analizat financiare dhe taksat që ndikojnë OJF-të në Shqipëri.

Qeverisja e Mirë

Qeverisja demokratike, transparenca, përgjegjshmëria dhe antikorrupsioni mbeten akoma çështjet më sfiduese që hasin shoqëritë e hapura në vendet e reja demokratike si Shqipëria. Zbatimi i teknikave të pjesëmarrjes publike në procese vendim-marrëse, programe trajnimi dhe asistence teknike për zyrtarët e administratës publike dhe qeverisjes vendore, sondazhe dhe vlerësime të cilësisë së shërbimeve publike, zhvillim i strategjive dhe planeve të veprimit për të kurrar dhe parandaluar korrupsionin në nivel vendor dhe lehtësimi i proceseve me pjesëmarrje, janë fushat kryesore të kontributit të PSH për Qeverisjen e Mirë.

- PSH kreu sondazhe në bashkitë e Durrësit, Krujës, Elbasanit, Kuçovës, Rubikut, Korçës, dhe Njësive Bashkiake 1 dhe 5 në Tiranë, mbi opinionin e qytetarëve për nivelin e ofrimit të shërbimeve publike. Gjetjet e sondazhit ndihmuan bashkitë të identifikonin çështjet problematike dhe të hartonin planet e veprimit për të përmirësuar shërbimet publike dhe rritjen e transparencës ndaj qytetarëve.
- PSH publikoi udhëzuesin “TË KTHENI SHËNDETIN E ORGANIZATËS TUAJ”, i cili u ofron punonjësve publikë mjete praktike për të kurrar dhe parandaluar korrupsionin në nivelin e qeverisjes vendore.
- PSH zhvilloi Strategjinë e Komunikimit të Brendshëm e të Jashtëm të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Zyrës së Avokatit të Prokurimeve Publike.
- PSH kreu një vlerësim të kapaciteteve të 335 punonjësve të Zyrës së Taksapaguesve të Mëdhenj dhe Zyrës së Taksapaguesve të Tiranës për të mbështetur stafin e tyre në ndarjen e përgjegjësive të reja funksionale dhe identifikimin e nevojave trajnuese.
- PSH kreu një studim mbi opinionin e klientëve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të biznesit mbi performancën e këtij institucioni, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në sportelet e saj të shërbimit në bashkitë Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Kukës.
- PSH organizoi katër workshope të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) mbi “Ligjin e Ri të Prokurimeve Publike” me 97 përfaqësues të kompanive të ndërtimit, Shoqatës së Ndërtuesve, Dhomës Shqiptare të Tregëtisë dhe Industrisë, Dhomës Amerikane të Tregëtisë dhe Shoqatës së Grave Profesioniste dhe Afariste.
- PSH lehtësoi organizimin e një workshopi të Ministrisë së Financave në lidhje me “Konsultimin mbi një draft të ri të Ligjit mbi Taksat”, me pjesëmarrjen e 48 përfaqësuesve të Shoqatës së Kontabilistëve e Shoqatës së Avokatëve të Shqipërisë.
- PSH organizoi dhe lehtësoi tre workshope mbi “Ligjin e Ri të Prokurimit Publik dhe Prokurimin Elektronik”, “Procedurat Përshtatëse e Ligji i Ri i Prokurimit Publik”, dhe “Integriteti Prokures dhe Antikorrupsioni” për 72 zyrtarë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Shkolla e Magjistraturës.
- PSH organizoi katër workshope informuese mbi Sistemin e Prokurimit elektronik, për 93 përfaqësues të medias, përfaqësuesve të Dhomës Shqiptare dhe asaj Amerikane të Tregëtisë, Shoqatës së Grave Profesioniste dhe Afariste dhe Konfindustrias.
- PSH ofroi trajnime mbi Kujdesin për Klientin për 42 punonjës të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Zyrën Qendrore të Taksave dhe Zyrës së Avokatit të Prokurimeve, në bashkëpunim me Departamentin për Edukimin dhe Informimin e Publikut të Projektit të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë.
- PSH organizoi dy tryeza të rrumbullakta për prezantimin e Avokatit të Prokurimeve, me pjesëmarrjen e 46 operatorëve ekonomikë.
- PSH organizoi 16 trainime mbi përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik për 477 zyrtarë të autoriteteve kontraktore dhe operatorë ekonomikë në Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Shkodër, Fier e Gjirokastrë.
- PSH organizoi katër Trajnime të Trajnerëve për 71 zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave mbi Mbledhjen e Taksave, Apelimin e Taksave, Auditin dhe Shërbimet e Taksapaguesve.

Zhvillimi i Sektorit të OJF-ve

Përgjatë periudhës 2006-2008, Partnerët-Shqipëri vazhdoi të investonte për një shoqëri civile më aktive. Fushat e veprimtarisë ishin:

1. Programi i Trajnimeve dhe Asistencës Teknike
2. Zhvillimi i Advokacisë së Shoqërisë Civile
3. Programi i Granteve të Vogla
4. Kuadri Ligjor i OJF-ve
5. Kodi i Etikës për Sektorin e OJF-ve

Programe Trajnimi dhe Asistencë Teknike

Trajnimet mbeten një kërkesë e vazhdueshme nga OJF-të shqiptare për rritjen e kapaciteteve të stafit dhe zhvillimin e organizatave në fushat e demokracisë dhe qeverisjes së mirë. Një monitorim efektiv i performancës së qeverisë kërkon një fuqizim të kapaciteteve të tyre, dhe zhvillim të bashkëpunimit dhe institucionalizimit të marrëdhënieve ndërmjet OJF-ve dhe qeverisë, duke kuptuar krijimin e forumeve të bazuara në pjesëmarrjen e OJF-ve.

Në periudhën 2006-2008 fokusi i asistencës së PSH për sektorin e OJF-ve ishte fuqizimi i kapacitetit institucional të OJF-ve dhe qendrueshmërisë së tyre, duke i krijuar atyre mundësinë të marrin pjesë në mënyrë më efektive në qeverisjen e mirë, advokaci dhe përpjekje lobuese, si dhe iniciativa antikorrupsion.

Trajnimi dhe asistencë për sektorin u zhvillua në kuadër të programeve Demokraci dhe Qeverisje e mirë në Shqipëri (DQSH), Rrjeti i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (NOSA), si dhe nëpërmjet një programi të mbështetur nga Qendra Olof Palme.

Programi i trajnimeve dhe asistencës teknike për sektorin gjatë 2006-2008, u hartua bazuar në vlerësimin e nevojave të sektorit të kryer në vitin 2005. Trajnimet e ofruara adresuan nevojat

e sektorit në tërësi por edhe ato individuale të organizatave të veçanta.

Programi i trajnimeve përfshiu temat e mëposhtme:

- Qeverisja me Pjesëmarrje dhe Teknikat për të Rritur Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendim-Marrje
- Lehtësimi i Proceseve me Pjesëmarrje
- Procedurat e Brendshme të OJF-ve dhe Manaxhimi Organizativ Efektiv
- Mobilizimi i Komunitetit në Proceset Zgjedhore
- Planifikimi Strategjik
- Legjislacioni Fiskal për OJF-të


PSH kreu mbi 34 trajnime në temat e sipërpërmendura, duke numëruar një total prej 552 përfituesish, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse (që punojnë në fushat e shërbimeve sociale, grave, të rinjve, të drejtave të njeriut, edukimit qytetar, demokracisë, promovimit të artit, kulturës, sportit dhe mjedisit), zyrtarë të pushtetit vendor, përfaqësues të biznesit, medias e grupeve të tjera të interesit.

Sipas një shpërndarjeje gjeografike të pjesëmarrësve, 17% e tyre vijnë nga veriu, 51% nga jugu, 8% nga Tirana dhe 24% nga Shqipëria qendrore. Përsa i përket shpërndarjes gjinore, 35% e tyre janë meshkuj dhe 65% femra.


Grafikët e mëposhtëm ofrojnë të dhëna rreth përfituesve të programit të trajnimeve dhe asistencës teknike, bazuar në shpërndarjen gjeografike, gjinore dhe temat e trajnimit ofruar përgjatë kësaj periudhe nga Partnerët-Shqipëri.

Gjatë vitit 2007, rreth 309 përfaqësues të OJF-ve aktive të Tiranës, Peshkopisë, Elbasanit, Librazhdit, Krujës, Fierit, Vlorës, Durrësit, Shkodrës, Pogradecit dhe Gjirokastrës morën pjesë në këto programe. Programi i trajnimeve të PSH synoi rritjen e nivelit të njohurive dhe përditësimin e pjesëmarrësve me teknika të


Shpërndarja gjeografike



Shpërndarja gjinore



Shpërndarja sipas temave



qeverisjes së mirë, avantazhet e përfshirjes në procese vendim-marrëse forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

PSH vazhdoi punën gjatë 2008-ës për fuqizimin e kapaciteteve të organizatave lokale për mobilizimin e komunitetit në proceset elektorale, për t'u përgatitur për zgjedhjet elektorale të 2009-ës. Rreth 122 përfaqësues të shoqërisë civile të Shkodrës, Durrësit, Fierit, Vlorës, Elbasanit, Beratit, dhe Korçës u trajnuan për të advokuar, lobuar dhe për të qenë më të përfshirë para dhe pas proceseve zgjedhore, me qëllim prioritarizimin e çështjeve me interes publik dhe monitorimin e realizimit të këtyre çështjeve nga institucionet qeveritare.

Për të rritur kapacitetet e OJF-ve dhe zhvillimin organizativ të tyre, Partnerët-Shqipëri ofroi

programe trajnimi në "Procedurat e brendshme të OJF-ve" për 88 përfaqësues të OJF-ve aktive të Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Shkodrës, Pogradecit dhe Tiranës.

Për të zhvilluar më tej kapacitetet manaxhuese organizative të OJF-ve, nëpërmjet një programi të mbështetur financiarisht nga Qendra Olof Palme, PSH trajnoi 20 përfaqësues të dhjetë OJF-ve në nivel kombëtar dhe i asistoi ato në hartimin e planeve strategjike.



Rezultatet e Programeve të Trajnimit dhe Asistencës Teknike

- Rreth 25 OJF që morrën pjesë në programet e trajnimit në Advokaci dhe Lobim ndërmorrën inisiativa advokuese, të fokusuar veçanërisht në përpjekjet për rritjen e transparencës qeverisëse dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset vendim-marrëse, dhe në mobilizimin e komunitetit.
- Rreth 61% e OJF-ve të trajnuara në Krijim Rrjetesh e Koalicioneve kanë punuar në koalicione pas periudhës së trajnimit. Çështjet që më së shumti bashkuan OJF-të në koalicione ishin promovimi i komunitetit dhe propozimi / lobimi për ndryshime ligjore.
- Rreth 30% e OJF-ve të trajnuara në Rolin e Shoqërisë Civile në Inisiativa Antikorrupsion, kanë një rritje të konsiderueshme në numrin e anëtarëve të përfshirë në inisiativa antikorrupsion në nivel lokal. Të paktën 35% e OJF-ve të trajnuara po implementojnë inisiativa të ndryshme të fokusuar në praktikant antikorrupsion.
- Mbi 66% e OJF-ve të trajnuara në Qeverisje me Pjesëmarrje dhe Teknika të Qeverisjes me Pjesëmarrje janë përfshirë aktivisht në takime të këshillave bashkiake, përpjekje monitoruese e të tjera.
- Rreth 80% e OJF-ve pjesëmarrësve në trajnime të Planifikimit Kooperues kanë përdorur procese të planifikimit kooperues si një mjet efektiv në evidentimin dhe sigurimin e mbështetjes së aktorëve kryesorë në përpjekjet e tyre.
- Dhjetë OJF hartuan plane strategjike dhe ngritën sisteme të brendshme financiare gjatë 2007: “Unë, Gruaja” dhe “Gruaja Intelktuale” në Pogradec, “Forumi i Grave” dhe “Shëndeti Publik” në Elbasan, “Koalicioni Shqiptar Kundër Trafikimit” dhe “Everychild” në Tiranë, “The Door” dhe “Shpresë për të Ardhmen” në Shkodër, “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë” në Kukës dhe “Shoqata e Grave me Probleme Sociale” në Durrës.
- Rreth 35 organizata të shoqërisë civile përmirësuan politikat dhe procedurat e tyre organizative.
- U hartuan plane veprimi për t’u ndërmarrë gjatë 2009-ës për rreth 22 çështje problematike që u ngritën gjatë trajnimeve.

Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Fushata Advokacie

Një rezultat kyç i aktiviteteve të PSH me organizatat e shoqërisë civile ishte rritja e përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen vendore. Një nga mënyrat më të rëndësishme se si qytetarët mund të influencojnë vendim-marrjen është nëpërmjet përpjekjeve advokuese. Përqasja e Partnerëve-Shqipëri ndaj përpjekjeve advokuese bazohet në strategjitë bashkëpunuese, angazhimin e vendim-marrësve dhe bashkëpunimin ndërsektorial.

Në kuadër të zgjedhjeve vendore të 18 Shkurtit 2007, PSH si partner në zbatimin e programit DQSH, inicioi dhe mbështeti fushatën lokale “UNË MBËSHTES QEVERISJEN E MIRË”. Qëllimi i kësaj iniciative ishte promovimi i qeverisjes së mirë, rritja e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse dhe fuqizimi i grupeve të interesit si një element i rëndësishëm i proceseve politike në Shqipëri, si dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës së të zgjedhurve vendorë në shtatë qytete të Shqipërisë, respektivisht Korçë, Pogradec, Shkodër Vlorë, Durrës, Gjirokastrë dhe Fier.

Metodologjia specifike advokuese e zgjedhjeve përfshiu: planifikimin e fushatës dhe manaxhimin e saj, zhvillimin dhe shpërndarjen e mesazhit, marrëdhëniet me median dhe komunikimin strategjik. Partnerët-Shqipëri përdori një kombinim të trajnimeve, mbështetjes financiare, lehtësimit dhe konsulencës për të ndërtuar kapacitetet advokuese të shtatë grupeve të interesit në qytetet e targetuara.

Qytetet dhe Përbërja e Grupeve të Interesit

Shkodër:	Një koalicion i organizatave rinore
Durrës:	Një koalicion i përbërë nga një organizatë grash, një organizatë rinore dhe përfaqësues të organizatave politike të gruas
Fier:	Një koalicion i organizatave rinore
Vlorë:	Një koalicion i organizatave rinore e organizatave të tjera
Gjirokastrë:	Përfaqësues nga OJF të ndryshme kulturore, të ruajtjes së trashëgimisë kulturore, turizmit dhe medias
Pogradec:	Një koalicion i OJF-ve me fokus anti-korrupsionin, mjedisin, gruan, edukimin, fëmijët dhe median
Korçë:	Një koalicion i OJF-ve të biznesit dhe individëve të biznesit

Iniciativa “Unë mbështes qeverisjen e mirë” u zbatua në periudhën para dhe pas zgjedhore. Në periudhën para-zgjedhore OJF-të lokale dhe qytetarë aktivë të bashkive u përfshinë në iniciativën “Unë mbështes qeverisjen e mirë”, dhe me mbështetjen e lehtësimin e PSH influencuan axhendat e kandidatëve për kryetarë bashkie në mbështetje të çështjeve të tyre. Iniciativa filloi me identifikimin e grupeve të shoqërisë civile që donin të kontribuonin për përmirësimin e demokracisë në nivel vendor, duke implementuar një fushatë bashkëpunuese advokacie. Në vende ku koalicionet apo shoqatat nuk ishin formuar ende për përmirësimin e nevojave të përbashkëta specifike emergjente, Partnerët bindën organizatat e shoqërisë civile të krijonin grupe të reja interesi.

Në të njëjtën kohë Partnerët-Shqipëri organizoi dhe lehtësoi workshope një ditore për grupet e interesit në secilin qytet për të ndihmuar ata në ngritjen dhe hartimin e një fushate advokuese. Në këto workshope morën pjesë rreth 200 pjesëmarrës, të rinj, gra, biznesmenë, OJF të ndryshme dhe qytetarë nga shtatë qytetet e targetuara. Partnerët-Shqipëri ndihmoi grupet të identifikonin nevoja kyçe komunitare, t'i japin përparësi atyre dhe të zgjidhin një çështje me interes të përbashkët. Po kështu stafi i Partnerëve-Shqipëri i udhëhoqi pjesëmarrësit drejt një procesi të zhvillimit të një plani të detajuar të aktiviteteve, buxhetimit dhe strategjive përkatëse për të tërhequr vëmendjen rreth këtyre çështjeve, identifikimin e aktorëve mbështetës dhe kontribuesve të tjerë të mundshëm. Ky model i zgjedhur nga PSH theksoi zhvillimin e shpërndarjen e materialeve ndërgjegjësuere publike. Secili grup zgjodhi një person ose një organizatë përgjegjëse për të koordinuar punën me Partnerët-Shqipëri dhe për të vepruar si koordinator, lehtësues dhe motivues.

Komponenti më sfidues i fushatës për grupet e interesit ishte organizimi i forumeve të hapura me

kandidatët për kryetarë bashkie. Partnerët-Shqipëri vuri në shërbim tërë rjetin e zgjeruar të koalicioneve në secilin qytet dhe përdori influencën e saj institucionale për të bërë të mundur realizimin e këtyre forumeve dhe transmetimin e tyre në mediat lokale. Për t'i bërë fushatat advokuese më të dukshme, Partnerët-Shqipëri u mbështetën në eksperiencën e mëparshme, legjitimitetin dhe rjetet e partnerëve të tjerë në zbatimin e programit DQSH. Në fund të fushatave grupet lokale të interesit mundën të organizonin forume të hapura në pesë nga shtatë qytetet e iniciativës. Rreth 1000 qytetarë morën pjesë në këto forume të hapura, të cilat u shfaqën në kanalet televizive lokale dhe ato kombëtare.

Më shumë se 2500 qytetarë në të shtatë qytetet u përfshinë aktivisht në aktivitete promovionale, debate të hapura dhe forume me kandidatët gjatë fushatave lokale, të cilat ndihmuan në krijimin e një kulturë të re ndërveprimi ndërmjet qytetarëve dhe politikanëve.

Në periudhën paszgjedhore, këto koalicione arritën të krijonin e fuqizonin gjashtë komisione këshillimi për qytetarët, të cilat rritën pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen vendore duke ofruar disa mekanizma komunikues formalë ndërmjet qytetarëve dhe bashkive të tyre për çështje të ndryshme si hartimi i buxhetit, çështjet rinore, promovimi i turizmit kulturor, çështje të biznesit dhe tregut si dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.

Partnerët-Shqipëri vazhdoi të mbështesë grupet e interesit për ndjekjen e iniciativave advokuese dhe angazhimin e kandidatëve deri në rezultatet finale. Rreth 60 përfaqësues të grupeve të targetuara në të gjitha qytetet u trajnuan mbi lehtësimin e proceseve pjesëmarrëse për të përmirësuar aftësitë e tyre.

Fuqizimi i bashkëpunimit dhe institucionalizimi i marrëdhënies ndërmjet OJF-ve dhe qeverisë në kuptimin e krijimit të forumeve të bazuara në pjesëmarrjen qytetare, ishte impakti kryesor i kësaj iniciative.

“Unë Mbështes Qeverisjen e Mire” – Rezultatet e Inisiativave Advokuese

Shkodër:	Themeloi një bord të politikave rinore
Durrës:	Themeloi një zyrë të Barazisë Gjimore në Bashki
Fier:	Bëri të mundur përmirësimin e shërbimeve lokale për të rinjtë dhe rritjen e buxhetit të bashkisë për çështjet problematike të të rinjve
Vlorë:	Themeloi një Komision Këshillimor pranë Bashkisë për çështjet e rinisë
Gjirokastrë:	Promovoi dhe zhvilloi trashëgiminë kulturore dhe historike nëpërmjet rritjes së buxhetit përkatës
Pogradec:	Ndërmori iniciativa për një administratë publike më efektive dhe të pakorruptuar
Korçë:	Nënshkroi një Pakt integriteti Antikorupsion



Programi i Granteve të Vogla

Partnerët-Shqipëri si pjesë e programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri administroi Fondin e Granteve të vogla, i cili ishte dizenuar të mbështeste zgjedhje të lira dhe të drejta, të kontribuonte në luftën kundër korrupsionit dhe të promovonte një transparencë më të madhe dhe llogaridhënieje në qeverisjen vendore dhe qendrore, nëpërmjet mbështetjes financiare për organizatat jofitimprurëse shqiptare.

Fondi për Demokraci dhe Qeverisje për Shqipërinë u ngrit për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe diskutimin në nivel kombëtar e vendor mbi çështje që lidhen me transparencën qeverisëse, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, si dhe për të rritur efektivitetin e organizatave të shoqërisë civile në përfundimin e një roli supervizues dhe advokues.

Gjatë periudhës 2006-2007 Partnerët-Shqipëri administroi raundin e katërt e të pestë të programit të granteve, duke akorduar afërsisht 270,000 dollarë në mbështetje të rreth 30 projekteve në fushën e advokacisë, zgjedhjeve dhe antikorrupsionit, të cilat adresuan çështje të ndryshme si:

- Monitorimi i zgjedhjeve vendore e parlamentare;
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset votuese;
- Monitorimi i përdorimit të shpenzimeve publike në periudhën para-zgjedhore;
- Monitorimi i transparencës financiare të partive politike gjatë fushatave elektorale;
- Përmirësimi i strukturës ligjore dhe infrastrukturës zgjedhore;
- Krijimi i një dialogu ndërmjet qeverisë vendore dhe bizneseve;
- Monitorimi i performancës së qeverisë në nivel vendor e qendror lidhur me ofrimin e shërbimeve, të drejtat e qytetarëve dhe strategjitë;
- Rritja e dialogut ndërmjet grupeve qytetare dhe qeverisë vendore për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrjen vendore, e të tjera.

Programi i granteve mundësoi OJF-të shqiptare dhe grupimet qytetare të rrisin kapacitetet e tyre në formulimin, implementimin dhe monitorimin e politikave publike, duke përfshirë dhënien e shërbimeve publike të nevojitura në nivel kombëtar e vendor. Programi i granteve gjithashtu inkurajoi qytetarët të promovojnë interesat e tyre dhe të adresojnë e prezantojnë problemet tek institucionet qeverisëse.

Para dhënies së granteve, Partnerët-Shqipëri ofroi informacion dhe konsultim nëpërmjet takimeve publike në qytete të ndryshme të Shqipërisë, për të shpjeguar kriteret e aplikimit dhe natyrën e projekteve, si dhe ofroi këshillime dhe asistencë teknike individuale në hartimin dhe zhvillimin e projekt-propozimeve. Gjatë implementimit të projekteve PSH ofroi trajnime dhe asistencë teknike organizatave përfituese të granteve për të fuqizuar kapacitetet e tyre advokuese dhe organizative dhe i asistoi ato drejt arritjes së rezultateve, objektivave dhe përpjekjeve të tyre monitoruese dhe mbikëqyrëse, për një qeverisje më të përgjegjshme dhe transparente ndaj publikut.

Partnerët-Shqipëri u ofroi grantive gjithashtu asistencë teknike të zgjeruar telefonike, me qëllim që gjatë procesit të implementimit të këtyre projekteve, OJF-të të bëheshin më të qendrueshme institucionalisht dhe financiarisht. Drejtimi profesional i ofruar nga stafi i Partnerëve-Shqipëri përfshiu këshillim në vendosjen e indikatorëve dhe planeve monitoruese, asistencë në manaxhim financiar, vizita në terren dhe asistencë në shkrimin e raporteve. Ajo çka vlen për të shtuar është se në raste kur projektet hasnin pengesa në zbatim, stafi i Partnerëve-Shqipëri ishte gjithmonë i gatshëm të këshillonte mbi mënyrat se si mund të kaloheshin vështirësitë për të bërë të mundur ecurinë e projektit.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Partnerët-Shqipëri dhe NDI punoi për të mobilizuar dhe koordinuar iniciativën më të madhe të monitorimit të zgjedhjeve vendore në historinë e Shqipërisë. Një koalicion i nëntë organizatave jofitimprururëse i quajtur "Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë" trajnoi dhe përgatiti më shumë se 2,500 monitorues vullnetarë të akredituar në 65 bashki, 53 komuna dhe 340 qendra numërimi në të gjithë Shqipërinë, duke mbuluar kështu 100% të bashkive dhe 18% të komunave të vendit.

Duke iu referuar eksperiencës së mëparshme të mbështetjes së koalicionit të OJF-ve që monitoruan zgjedhjet kombëtare të 2005-ës, Partnerët-Shqipëri vendosi disa standarte dhe pritshmëri të reja për përpjekjen monitoruese të 2007-ës. Këto masa siguruan një përmirësim të dukshëm nga zgjedhjet e 2005-ës në drejtim të sasisë, cilësisë, shpejtësisë së mbledhjes së informacionit nga monitoruesit në ditën e zgjedhjeve.

Partnerët-Shqipëri dhe NDI themeluan një Qendër Operative të Monitorimit të Zgjedhjeve dhe krijuan një databazë të gjithanshme rreth informacionit të zgjedhjeve për të ndihmuar në organizimin dhe manaxhimin e përpjekjes monitoruese të 2007-ës.

Rezultatet Kryesore të Programit të Granteve të Vogla

- Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore të 18 Shkurtit 2007, mbuloi 2301 qendra votimi, respektivisht 71% të votuesve në 118 zonat më të populluara. Kjo përpjekje monitoroi procesin e votimit dhe numërimit të votave në 100% të bashkive dhe 18% të komunave. Partnerët-Shqipëri lehtësoi krijimin e këtij grupi monitorues dhe ofroi asistencë teknike për të siguruar që përpjekja monitoruese të ishte e mirë-koordinuar dhe organizuar;
- U zhvilluan 120 seanca trajnime në të gjithë vendin për të krijuar kapacitetin e nevojshëm profesional të vëzhguesve vendorë;
- Aktiviteti monitorues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë gjatë ditës së zgjedhjeve pati një pasqyrim të gjerë mediatik. U publikuan artikuj në 30 gazeta politike dhe të pavarura lokale, gjithashtu monitorimi u pasqyrua në edicionet kryesore të lajmeve në rreth 10 televizione lokale dhe kombëtare;
- Për herë të parë në Shqipëri informacioni u ofrua në kohë reale nëpërmjet teknologjisë së dërgimit të mesazheve. Ky informacion u ofrua nëpërmjet 40,000 mesazheve që u procesuan deri në mbyllje të qendrave të votimit;
- Koalicioni monitoroi zgjedhjet e pjesshme parlamentare në zonën 26 në Shijak të prefectures së Durrësit, duke mbuluar 100% të qendrave të votimit;
- Roli i shoqërisë civile në procesin zgjedhor pati një rritje të ndjeshme në influencimin e aktorëve kryesorë për respektimin e ligjit.
- Krijimi i Koalicionit të Biznesit Korçar kundër Korrupsionit promovoi dhe enkuroi dialogun ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve vendore si dhe ndihmoi në krijimin e një ambienti pa rryshfete dhe konkurrencë të drejtë.



Kjo databazë e informacionit zgjedhor do të jetë një mjet kyç për organizimin dhe manaxhimin e përpjekjeve të ardhshme monitoruese. Pavarësisht se përpjekja ndihmoi në krijimin e aftësive monitoruese zgjedhore për nëntë OJF shqiptare, ato përsëri kanë ekspertizë teknike të pamjaftueshme për të udhëhequr vetë një iniciativë komplekse të këtij tipi.

Kuadri Ligjor i OJF-ve

Partnerët-Shqipëri që nga themelimi i saj ka luajtur një rol aktiv në amendimin e kuadrit ligjor për sektorin e OJF-ve. Ky rol vjen falë eksperiencës dhe kontributit të stafit të PSH i cili daton që në vitet e para të ekzistencës së sektorit të OJF-ve në Shqipëri. Në këtë kuadër PSH ka bashkëpunuar ngushtë me institucione kombëtare e ndërkombëtare të interesuar për të ofruar ekspertizën dhe mbështetjen e tyre në zhvillimin e kuadrit ligjor të sektorit të OJF-ve në Shqipëri.



Periudha 2006-2007 u shoqërua me një seri ndryshimesh e amendimesh të kuadrit ligjor të OJF-ve, të cilat sollën një rritje të pengesave tatimore për sektorin. Projekt-ligji i propozuar nga qeveria shqiptare shënon disa ndryshime në nenet lidhur me lehtësirat dhe përjashtimet nga detyrimet fiskale të OJF-ve.



Informacioni nga strukturat qeveritare mbi këtë çështje dhe konsultimet paraprake me sektorin e OJF-ve para draftimit të këtij projekt-ligji ishin pothuaj joekzistente. Në këto kushte një grup përfaqësuesish të organizatave joqeveritare, përfshi këtu dhe Partnerët-Shqipëri, Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Co-Plan, Qendrën e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, CANGO Albania dhe Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, organizuan gjatë 2007-ës disa debate brenda sektorit, dhe ndërmorën disa hapa drejt rishikimit të projekt-ligjit duke kërkuar nga parlamenti shqiptar dhe qeveria një përfshirje më të gjerë të grupeve të interesit në të tilla konsultime.



Partnerët-Shqipëri morën rolin e lehtësuesit të procesit të këtyre diskutimeve brenda sektorit, dhe lobuan me ministritë përkatëse dhe komisionet parlamentare, gjithashtu krijuan mundësinë e përfshirjes së ekspertizës kontribuuese nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kësaj çështje. Të gjitha këto aktivitete u bënë të mundura

me anë të organizimit të disa takimeve me përfaqësues të sektorit, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, si dhe pjesëmarrjen e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë. Përfaqësues të OJF-ve, nismëtarë të kësaj iniciative morën pjesë në një sesion të Komisionit Parlamentar të Çështjeve Ligjore, ku diskutuan në detaje projekt-ligjin dhe mundësinë e amendimit të tij. Kjo iniciativë pati një pasqyrim të gjerë mediatik, ku u theksua roli i sektorit të OJF-ve për zhvillimin e vendit.

Për asistuar përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile për të qenë konform kuadrit ligjor PSH përgatiti dhe publikoi një Manual të Manaxhimit Financiar, i cili do të shërbejë si një mjet për të rritur kapacitetet e tyre në manaxhim financiar.

PSH organizoi në Janar 2008 një trajnim të avancuar me pjesëmarrjen e financierëve të OJF-ve dhe disa ekspertëve të ligjit të taksave.

Gjithashtu gjatë 2008 PSH luajti një rol aktiv për të kundërshtuar iniciativat ligjore dhe akte të tjera normative mbi detyrimet fiskale të OJF-ve. Këto iniciativa konsistuan në lehtësimin e diskutimeve brenda sektorit të OJF-ve, komunikimin me institucionet qeveritare, takimet me struktura dhe donatorë ndërkombëtarë, si dhe bërjen publike të kësaj çështje nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

Kodi i Etikës për OJF-të

Gjatë periudhës 2006-2008, me iniciativë të Partnerëve-Shqipëri u organizua një lëvizje e gjerë në sektorin jofitimprurës në të gjithë territorin e vendit me qëllim hartimin e një Kodi Etike për OJF-të.

Gjatë vitit 2006 Partnerët – Shqipëri organizoi një seri tryezash diskutimi me organizata lokale të shoqërisë civile në qytete të ndryshme të vendit, me qëllim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e një dokumenti të tillë dhe dhënien e kontributit për hartimin e tij. Rreth 200 përfaqësues të OJF-ve të Vlorës, Pogradecit, Gjirokastrës, Durrësit, Shkodrës, Elbasanit dhe Tiranës morën pjesë në këto takime.

Kodi është një mekanizëm vet-rregullues, një mjet për të ndërtuar organizata më të forta dhe më efektive në sektorin e shoqërisë civile. Një Kod Etike mund të shërbejë për rritjen e efikasitetit të organizatave jo-fitimprurëse duke krijuar një bazë mbi të cilën të vlerësohen dhe të përmirësohen praktikatat e drejtimit. Mbi baza vullnetare dhe vet-rregulluese, Kodi siguron transparencë dhe përgjegjshmëri në funksionimin e OJF-ve si dhe synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrojnë OJF-të, duke i mbështetur ato në adaptimin e standarteve më të larta të sjelljes dhe etikës si dhe të procedurave vendim-marrëse më efektive. Ai gjithashtu synon përmirësimin e komunikimit brenda sektorit të OJF-ve dhe midis tij e aktorëve të tjerë, si dhe përmirësimin e performancës së OJF-ve përmes shkëmbimit të eksperiencës mes tyre dhe mësimit nga praktikatat më të mira.

Gjatë periudhës 2007-2008, PSH vijoi me diskutime brenda sektorit për strukturën e Kodit dhe përmbajtjen e tij. Një grup ekspertësh me eksperiencë të gjatë në sektor punuan për draftin e Kodit të Etikës, bazuar në syzjerimet e dhëna nga përfaqësues të OJF-ve në takimet e realizuara në qytete të ndryshme të vendit si dhe në modele ndërkombëtare të Kodeve të Etikës për OJF-të. Partnerët – Shqipëri organizoi tre tryeza kombëtare me pjesëmarrjen e OJF-ve lokale më aktive për diskutimin e komponentëve kryesorë të Kodit, strukturën dhe draftin e dokumentit. Në tryezën e fundit në Qershor 2008, përfaqësues të OJF-ve të cilët aprovuan dokumentin përfundimtar, vendosën gjithashtu procedurat e akreditimit dhe kriteret e anëtarësimit, si dhe modalitete të tjera lidhur me manaxhimin dhe lehtësimin e këtij procesi në të ardhmen. Mekanizmat e akreditimit përfshijnë Asamblenë e Përgjithshme, Komitetin për Monitorimin e Kodit dhe Sekretariatit.

Kodi i Etikës i cili sapo ka nisur të implementohet duhet konsideruar si një përpjekje më shumë e të gjithëve për transparencë e profesionalizëm në sektorin jo-fitimprurës.

Realizimi i iniciativës për hartimin e Kodit u mbështet nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë në kuadër të programit të Rrjetit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri.

Kontributi në Qeverisjen e Mirë në Nivel Vendor dhe Qendror

Gjatë 2006-2008, Partnerët-Shqipëri punoi me administratën e pushtetit qendror e vendor mbi çështje të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje.

Përpjekjet e PSH u fokusuan në:

- Rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për adaptimin dhe zbatimin e planeve për të kuruar dhe parandaluar korrupsionin;
- Rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë duke bërë veprimtarinë e saj më transparente;
- Forcimin e ndërveprimit midis aktorëve të shoqërisë civile dhe qeverisë.

Trajnime dhe Asistencë Teknike për Stafin e Bashkive

Programet e asistencës së Partnerëve-Shqipëri ndihmuan pushtetin vendor të jetë më pranë qytetarëve dhe të përmirësojë kapacitetet në ofrimin e shërbimeve. Kjo u bë e mundur nëpërmjet:

- Një asistencë të orientuar sipas nevojave të zyrtarëve të administratës vendore në identifikimin e nevojave të komunitetit, hartimin e procedurave transparente dhe ofrimin efektiv të shërbimeve.
- Trajnime me grupe të përziera në qeverisjen me pjesëmarrje dhe teknikat e qeverisjes për përfaqësues të pushtetit vendor, shoqërisë civile, medias dhe biznesit.

Puna e Partnerëve-Shqipëri në këtë fushë është mbështetur nga USAID nëpërmjet programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë nëpërmjet Rrjetit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, dhe Fondacioni i Partnerëve për Zhvillim Lokal në kuadër të programit rajonal “Të Punojmë së Bashku”.

Promovimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Qeverisjen Vendore

Shqipëria është një nga vendet me nivel më të lartë korrupsioni në Europë. Sipas Transparencës Ndërkombëtare, mbi 40% e shqiptarëve të pyetur për “Barometrin Global të Korrupsionit 2006” ka paguar rryshfet në vitin e fundit. Korrupsioni i përhapur në të gjithë Shqipërinë ka një efekt shkatërrues për zhvillimin e vendit në tërësi duke penguar kështu procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian, duke rritur varfërinë, duke dekurajuar investimet e huaja dhe rritjen ekonomike.

Korrupsioni është një problem i cili nuk mund të adresohet vetëm në nivele të qeverisjes qendrore, por gjithashtu është një shqetësim i drejtpërdrejtë i qeverisjes vendore. Pasoja të praktikave korruptive në nivel vendor në Shqipëri janë shërbime publike të varfëra dhe joeficiente, rritja e dallimeve sociale, ulja e investimeve dhe rënia e zhvillimit ekonomik.

Për të adresuar këtë problem, Partnerët-Shqipëri është duke zbatuar programin “Të punojmë së bashku për të bërë qeverisjen vendore më transparente e të përgjegjshme”. Qëllimi është rritja e përgjegjshmërisë së qeverisjes vendore duke e bërë veprimtarinë e saj më transparente, e duke reduktuar në këtë mënyrë mundësinë e infiltrimit të korrupsionit. Partnerët-Shqipëri beson në një korrelacion të drejtpërdrejtë ndërmjet reduktimit të korrupsionit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve publike. Partnerë në këtë program janë gjashtë bashki të Shqipërisë dhe dy njësi bashkiake në Tiranë.

Iniciativa nisi me publikimin e një guide praktike për kurimin dhe parandalimin e korrupsionit në nivelet e qeverisjes vendore “Të Ktheni Shëndetin e Organizatës Tuaj”, guidë kjo që iu prezantua përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit në Shqipëri, në

një workshop një-ditor “Workshop Kombëtar për Kryetarët e Bashkive”, në Nëntor 2007.

Në workshop u diskutua rreth metodave pjesëmarrëse si një mënyrë për të diagnostikuar dhe parandaluar korrupsionin në nivel vendor si dhe u ftuan bashkitë pjesëmarrëse në workshop të bëheshin pjesë e programit. Krahas aplikimeve nga shumë bashki, PSH zgjodhi për të zbatuar programin në bashkitë e Kuçovës, Rubikut, Korçës, Elbasanit, Krujës, Durrësit dhe Njësitë Bashkiake 1 dhe 5 në Tiranë.

Në bashkitë e sipërpërmendura, PSH kreu sondazhe mbi opinionin e qytetarëve për nivelin e ofrimit të shërbimeve publike. Rezultatet e këtij studimi u paraqitën më pas në të gjitha bashkitë e përfshira në program dhe do të vazhdohet të diskutohen në workshopet e ardhshme rajonale dhe kombëtare që do të zhvillohen me pjesëmarrjen e qeverisjes vendore dhe aktorëve të shoqërisë civile.

Si një hap të dytë, PSH po asiston bashkitë në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit në kuadër të strategjive antikorrupsion. Programi po vë në zbatim përjasje të reja pjesëmarrëse në kurimin e korrupsionit



duke ngritur rrjete të qëndrueshme ndërmjet shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe pushtetit vendor, si dhe duke ndërtuar kapacitetet monitoruese në nivel vendor.

Ky program mbështetet financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Ambasada Britanike dhe ajo e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë, si dhe Fondacioni i Partnerëve për Zhvillimin Lokal.

Mbështetja e Transparencës në Qeverisjen Qendrore

Për dy vite Partnerët-Shqipëri ishte partner në zbatim i Projektit të Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë. Ky projekt mbështeti qeverinë shqiptare në reformimin dhe modernizimin e administratës së tatimeve, prokurimeve publike dhe regjistrimin e biznesit, si dhe ndërtimin e një sistemi të integruar përmes teknologjisë së informacionit të ‘fjalës së fundit’ për manaxhimin e procesit të biznesit dhe qeverisjen elektronike.

Hartimi i Strategjive të Komunikimit

PSH zhvilloi Strategjinë e Komunikimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Avokatit të Prokurimeve (AvP). Qëllimi i strategjisë ishte rritja e efikasitetit dhe transparencës së institucioneve përmes një komunikimi më efektiv me audiencën e brendshme dhe të jashtme, zhvillimi i një plani komunikimi të brendshëm e të jashtëm dhe identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e tij.

PSH zhvilloi gjithashtu një seri mjetesh komunikimi në mbështetje të strategjisë, që përfshinin një gazetë, përshkrimin e punës për punonjësin e marrëdhënieve me publikun, sugjerime lidhur me faqen e internetit, formate standarte dhe analize të dhënash, informacion mbi median dhe operatorët ekonomikë.

Realizimi i Studimeve dhe Vlerësimeve

Gjatë periudhës Prill - Maj 2008, Partnerët-Shqipëri ndërmori studimin “Vlerësimi i kapaciteteve të Zyrës së Taksapaguesve të Mëdhenj (ZTM) dhe Zyrës së Taksapaguesve

të Tiranës (ZTT)", duke targetuar 335 zyrtarë nga këto dy institucione. Qëllimi i studimit ishte rivendosja e stafit të ZTM dhe ZTT në pozicionet e punës sipas ndarjes së re të funksioneve në kuadër të riorganizimit të administratës së taksave dhe identifikimi i nevojave të stafit për trajnim në lidhje me aftësitë dhe njohuritë që kërkojnë funksionet e reja. Vlerësimi u krye nëpërmjet pyetësorëve standartë dhe intervistave individuale.

Gjatë periudhës Mars - Qershor 2008, Partnerët-Shqipëri kreu studimin "Monitorimi i performancës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) mbi dhënien dhe shpërndarjen e shërbimeve". Objektivi kryesor i këtij studimi ishte vlerësimi i performancës së QKR-së lidhur me shërbimet ndaj klientëve, perceptimin e klientëve për QKR-në dhe ngritjen në QKR të një procesi të qendrueshëm të vlerësimit nga vetë klientët të shërbimeve të ofruara prej saj.

Partnerët-Shqipëri kryen 1,605 intervista në nëntë sportele shërbimesh të QKR-së përfshirë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe tetë sportele shërbimesh në bashkitë e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Korçës, Fierit, Shkodrës, Kukësit dhe Gjirokastrës.

Monitorimi u bazua në intervista të drejtpërdrejta me klientët pas marrjes së shërbimit në sportelet e QKR-së, si dhe diskutimet në grupe të fokusuar. Pyetësori i përdorur për intervistat mundësoi të dhëna sasiore mbi eksperiencën e klientëve me shërbimet e QKR-së. Diskutimet e mëpasme në grupe të fokusuar krijuan mundësinë e shkëmbimit të një eksperience më të detajuar me klientët e QKR-së, për të përfutur një kontekst më të gjerë karshi të dhënave të pyetësorëve dhe për të shpjeguar tendencat e vëzhguara, duke udhëhequr në këtë mënyrë përfundime interpretuese të mirëbazuara.

Organizimi dhe Lehtësimi i Aktiviteteve

Që në Shtator 2006 Partnerët – Shqipëri si partner në zbatim i Chemonics International në Projektin e Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë asistoi në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Administratës Tatimore, Prokurimit Publik dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të biznesit. Partnerët lehtësoi gjithashtu organizimin e një serie trajnimesh dhe tryezash të rrumbullakta me pjesëmarrjen

e këtyre institucioneve, me qëllim informimin e tyre dhe grupeve të tjera të interesit mbi Ligjin për Prokurimin Publik, Prokurimin Elektronik, Kujdesin për Klientin etj.

Vetëm në 2007 numri i pjesëmarrësve në këto evenimente ishte 352 punonjës të administratës publike dhe përfaqësues të grupeve të interesit.

PSH luajti një rol të rëndësishëm në lehtësimin e një serie workshopesh të Agjencisë së Prokurimit Publik mbi "Ligjin e Ri të Prokurimit Publik". Rreth 97 pjesëmarrës në këto workshope përfaqësonin kompani ndërtimi, Shoqatën e Ndërtuesve, Dhomën Shqiptare të Tregëtisë dhe Industrisë, Dhomën Amerikane të Tregëtisë dhe Shoqatën e Grave Profesioniste dhe Afariste.

Në Tetor 2007, Ministria e Financave me asistencën e Projektit organizoi një workshop lidhur me "Konsultimin mbi Draftin e Ri të Ligjit për Procedurat Tatimore", me pjesëmarrjen e 48 përfaqësuesve të Shoqatës së Kontabilistëve dhe Shoqatës së Avokatëve të Shqipërisë. Partnerët-Shqipëri lehtësoi organizimin e workshopit dhe koordinuan punën me stafin e projektit.

Në vijim, Partnerët-Shqipëri organizuan në Nëntor 2007 tre workshope mbi Ligjin e Ri të Prokurimit Publik, Prokurimin Elektronik, Procedurat Ndëshkuese, si dhe mbi Integritetin në Prokurim dhe Antikorrupsionin, me pjesëmarrjen e 72 përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Zyrës së Avokatit të Prokurimeve dhe Shkollës së Magjistraturës.

Gjatë Dhjetorit 2007 u organizuan dhe katër workshope të tjera mbi Prokurimin Elektronik me pjesëmarrjen e 93 përfaqësuesve të medias, të Dhomës Shqiptare dhe asaj Amerikane të Tregëtisë, Shoqatës së Grave Profesioniste dhe Afariste dhe Konfindustrias.

Po në Dhjetor 2007, Partnerët-Shqipëri në bashkëpunim me Projektin e Sfidës së Mijëvjeçarit ofruan tre trajnime në "Kujdesi për Klientin", për 42 punonjës të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrës së Avokatit të Prokurimeve.

Gjatë Prillit 2008, PSH organizoi dy tryeza të rrumbullakta me pjesëmarrjen e 46



operatorëve ekonomikë në lidhje me funksionet e zyrës së Avokatit të Prokurimeve.

Gjatë vitit 2008 u organizuan gjashtëmbëdhjetë trajnime mbi prokurimin elektronik me pjesëmarrjen e 477 zyrtarëve të autoriteteve kontraktuese dhe dhe përfaqësuesve të komunitetit të biznesit në Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Shkodër, Fier e Gjirokastrë.

Katër Trajnime për Trajnerë në lidhje me mbledhjen e taksave, kontrollin dhe apelimet u organizuan gjatë muajit Korrik - Gusht 2008 me pjesëmarrjen e rreth 71 zyrtarëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.



Eksperiencia Ndërkombëtare e Aktiviteteve të PSH

Rritja e Kapaciteteve të Qendrës Burimore për Trajnime Advokacie (QBTA), Kosovë

Gjatë Korrik 2007 - Janar 2008 Partnerët - Shqipëri asistuan ekipin e trajnerëve të QBTA në zhvillimin e kurrikulës së re të trajnimeve dhe aftësive nëpërmjet ofrimit të një serie programesh Trajnimi për Trajnerë.

Programi i trajnimit përfshiu çështje mbi Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingun për OJF-të, Manaxhimin e Ciklit të Projektit, Komunikimin dhe Negocimin, Manaxhimin e Burimeve Njerëzore, Qeverisjen me Pjesëmarrje, Rolin e Shoqërisë Civile në Iniciativat Antikorrupsion, Planifikimin Kooperues dhe Buxhetimin me Pjesëmarrje.

PSH asistoi dhe departamentin e granteve të QBTA në rishikimin dhe përmirësimin e procedurave të manaxhimit të granteve dhe metodologjinë e punës me përfituesit e granteve.

Forcimi i Qeverisjes së Mirë në Lindjen e Mesme

PSH zhvilloi dy TOT katër ditore në "Qeverisje të Mirë, Transparencë, Llogaridhënie dhe Mobilizim Qytetar në Jetën Politike", për 28 trajnerë të shoqërisë civile dhe të qeverisë vendore në Jordani.

Trajnimi trajtoi çështje lidhur me qeverisjen e mirë si llogaridhënia, transparenca, përgjegjshmëria, pjesëmarrja, përfshirja dhe antikorrupsioni. Trajnimi i parë u fokusua në teknika të qeverisjes me pjesëmarrje ndërsa i dyti në disa teknika për mobilizimin e qytetarëve në jetën politike.

Disa komente nga stafi i QBTA:

Ne e vlerësojmë si tepër cilësore metodologjinë trajnuese të trajnerëve të PSH si dhe përmbajtjen e çdo çështjeje të trajtuar. Ne vlerësojmë materialet bashkëkohore dhe praktike që grupi trajnues i PSH solli në Qendër dhe metodologjinë pjesëmarrëse të aplikuar në trajnime...

Trajnerët e PSH ndanë njohurinë dhe eksperiencën e tyre, dhe diskutuan për secilin modul që prezantuan. Sesionet konsultative ishin efikase dhe ndihmuan në rishikimin dhe zhvillimin e moduleve të Qendrës në të ardhmen...

Shumica e temave të TOT ishin të reja për kurrikulën trajnuese të QBTA-së dhe ne duhet të punojmë shumë për t'i përshtatur ato me kontekstin vendas...




Sesionet e TOT mbi hartimin e planeve të veprimit ishin një ndihmë dhe mbështetje e madhe për ne si trajnerë...

Analizat SWOT na ndihmuan të vlerësojmë kapacitetin e Qendrës dhe të planifikojmë një kurs veprimi për adresimin e dobësive dhe rrisqeve. Diskutimet mbi politikat dhe procedurat e brendshme, stilet e manaxhimit dhe lidhshmit ndihmuan vizionin tonë në lidhje me strategjitë e brendshme të komunikimit...



Partnerët - Shqipëri si Qendër Burimore

Publikimet

Titulli i publikimit	Përshkrimi	Viti
 <p>Adresari i OJF-ve Shqiptare 2007 - Edicioni i Tretë</p>	<p>Ofron një pamje të përgjithshme të sektorit të OJF-ve dhe synon lehtësimin e komunikimit brenda sektorit, dhe ndërmjet OJF-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, biznesit dhe medias.</p> <p>Ky publikim është i disponueshëm në anglisht e shqip dhe mund të aksesohet online në faqen e internetit të PSH.</p>	2007
 <p>Advokacia dhe Zgjedhjet Vendore, Eksperiencia Shqiptare në 2007- Udhëzuesi i Praktikave më të Mira</p>	<p>Kjo analizë retrospektive thekson risitë dhe praktikat më të mira që lidhen me advokimin qytetar dhe përpjekjen monitoruese të zgjedhjeve në kuadër të programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri. PSH punoi në fushata advokuese komunitare duke krijuar mundësi të reja për pjesëmarrjen qytetare në proceset vendim-marrëse.</p> <p>Publikimi është i disponueshëm në shqip dhe anglisht.</p>	2008
 <p>Manaxhimi Financiar i OJF-ve - Koncepte Bazë</p>	<p>Ky publikim është një prezantim me sistemet llogaritëse dhe raportuese, kontrollet e brendshme, procesin e buxhetimit, analizat financiare dhe taksat që afektojnë OJF-të në Shqipëri.</p> <p>Publikimi është i disponueshëm në shqip dhe anglisht.</p>	2008



Konceptet dhe Strategjitë (Një Udhëzues Praktik për të Kruar dhe Parandaluar Korrupsionin në Qeverisjen Vendore dhe Komunitetet) 2008

Publikimi është i disponueshëm në shqip.

Të Ktheni Shëndetin e Organizatës suaj-Volumi 1

Të Ktheni Shëndetin e Organizatës suaj -Volumi 2

Mjetet e Lehtësimit të Procesit (Një Udhëzues Praktik për të Kruar dhe Parandaluar Korrupsionin në Qeverisjen Vendore dhe Komunitetet) 2008
Publikimi është i disponueshëm në shqip.



Zhvillimi i Kurrikulës Trajnuese

Partnerët-Shqipëri ofron trajnime për të zhvilluar aftësitë e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, qeverisë dhe sektorit të biznesit në këto tema:

Trajnimet për Pushtetin Vendor

Autonomia e qeverisjes vendore dhe decentralizimi i pushtetit nga nivel qendror në atë vendor shoqërohet nga shumë sfida institucionale. Për të asistuar qeverisjen vendore për t'iu përgjigjur përgjegjësisë në rritje dhe për të zbatuar rolin manaxhues dhe drejtues që kërkon decentralizimi, Partnerët-Shqipëri ka hartuar një seri programesh trajnime.

Trajnimet Ndërsektoriale dhe Trajnimet për OJF-të

Planifikimi Kooperues Sipas Modelit të Partnerëve
Lehtësimi i Proceseve me Pjesëmarrje
Komunikimi
Manaxhimi i Konfliktit
Negocimi
Mediacioni
Advokacia dhe Lobimi
Qeverisja e OJF-ve
Procedurat e Brendshme për OJF-të
Manaxhimi i Kohës dhe i Zyrës
Lidershipi dhe Mbikqyrja
Ndërtimi i Ekipit
Planifikimi Strategjik
Sigurimi i Fondeve dhe Vetëfinancimi i OJF-ve
Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingu për OJF-të
Krijimi i Rrjeteve dhe Koalicioneve
Ndryshimi Social në Komunitet
Vlerësimi i Nevojave të Komunitetit
Shkrimi i Projekt Propozimeve
Cikli i Manaxhimit të Projektit
Monitorimi dhe Vlerësimi
Manaxhimi Financiar
Advokacia me Pjesëmarrje
Iniciativat Antikorrupsion të Shoqërisë Civile

Manaxhimi i Burimeve Njerëzore
Roli i Zyrtarëve të Zgjedhur Vendorë
Kodi i Etikës për Zyrtarët Bashkiakë
Planifikimi Strategjik për Pushtetin Vendor
Manaxhimi Financiar dhe Transparenca në Pushtetin Vendor
Aftësitë Komunikuese dhe Përfshirëse për Zyrtarët Vendorë
Elementet e një Qeverisje Transparente dhe Llogaridhënëse
Qeverisja me Pjesëmarrje dhe Teknikat e Pjesëmarrjes
Buxhetimi me Pjesëmarrje
Përqasja e Kurimit dhe Parandalimit të Korrupsionit në Qeverisjen Vendore

Trajnimet për Sektorin Privat

Zhvillimi i një sektori privat të fuqishëm dhe dinamik në Shqipëri në vitet e fundit ka treguar nevojën e një kualifikimi të mëtejshëm për manaxherët dhe punonjësit e kompanive. Partnerët-Shqipëri ka përgatitur një paketë të veçantë trajnime dhe asistence teknike të përshtatur sipas nevojave të sektorit privat.

Kujdesi Ndaj Klientit dhe Shitjet Efektive
Komunikimi
Komunikimi dhe Shitjet në Telefon
Manaxhimi i Konfliktit dhe Negocimi
Manaxhimi i Ndryshimit Organizativ
Puna në Ekip
Lidershipi, Vendim-Marrja dhe Zgjidhja e Problemeve
Shitjet dhe Promocioni
Orientimi, Mbështetja dhe
Supervizimi i Performancës në Punë
Procesi i Rekrutimit dhe Intervistimit
Manaxhimi Efektiv i Kohës dhe Stresit në Punë

Programi i Lidershipit të Gruas

Partnerët-Shqipëri mbështet zhvillimin e rolit drejtues të gruas nëpërmjet rritjes së aftësive të saj në lidership dhe krijimit të rrjeteve e koalicioneve, aftësi të cilat do të mundësojnë atë të mbrojë më mirë të drejtat e saj dhe të kontribuojë në zhvillimin e vendit.

Temat e Programit:

Aftësitë Komunikuese
Marrëdhëniet Publike, të Folurit
në Publik dhe Imazhi Publik
Ndërtimi i Grupeve, Rrjeteve dhe Koalicioneve
Lidershipi dhe Manaxhimi
Manaxhimi i Konfliktit, Negocimi dhe Mediacioni
Lehtësimi
Advokacia dhe Lobimi
Planifikimi Kooperues
Planifikimi Strategjik
Shkrimi i Projekt Propozimeve
dhe Cikli i Manaxhimit të Projektit
Manaxhimi Financiar

Programi i Lidershipit të Rinisë

Për të përgatitur profesionistët e rinj nga OJF-të, qeverisja vendore dhe qendrore, dhe sektori i biznesit, për përmbushjen e potencialit të tyre udhëheqës si dhe për të mundësuar ata të bashkëveprojnë në situata shumëdimensionale dhe bashkëpunuese që i nevojiten zhvillimit social, Partnerët-Shqipëri ka zhvilluar një paketë trajnuese.

Lidershipi dhe Manaxhimi
Manaxhimi i Konfliktit, Negocimi dhe Mediacioni
Aftësitë Komunikuese
Ndërtimi i Grupeve, Rrjeteve dhe Koalicioneve
Shkrimi i Projekt Propozimeve
dhe Cikli i Manaxhimit të Projektit

Lehtësimi
Advokacia
Marrëdhëniet me Publikun

Trajnimet për Trajnerë

Cikli i të mësuarit për të rriturit
Stilet e të mësuarit
Fazat e të nxënit
Si të organizojmë një trajnim të efektshëm
Pregatitja për trajnim
Roli i trajnerit
Diversiteti i grupeve
Manaxhimi i dinamikës së grupit
Metodologjia e trajnimit, teknikat kryesore të përdorura gjatë tij
Pregatitja e një axhende dhe plan sesioni të trajnimit
Përdorimi me efektivitet i mjeteve ndihmëse
Vlerësimi i trajnimit

Biblioteka

PSH ka një koleksion të pasur publikimesh, artikujsh, raportesh, gazetash të ndryshme në fusha si Legjislacioni, të Drejtat e Njeriut, Zhvillimi social dhe ekonomik, Vendim-marrja, Etika, Manaxhimi, Negocimi dhe Manaxhimi i Konfliktit, Antikorrupsioni dhe Antitrafikimi, Advokacia, Ndryshimi Social, Zgjidhja e Problemeve, Publikime mbi Varfërinë, Sektori i Biznesit, OJF-të, Mjedisi, Financa, Media dhe informacione burimore si Fjalorë, Enciklopedi, Adresarë etj.

Publikimet janë të disponueshme në gjuhët shqip dhe anglisht.

Programi i Internshipit

Partnerët-Shqipëri ofron internshipe për studentë dhe pasuniversitarë në kërkim të aftësive dhe eksperiencave të reja në funksion të karrierës së tyre. Programi i internshipit i PSH u ofron mundësi studentëve të përfitojnë eksperiencë dhe të mësojnë mbi etikën e punës nëpërmjet trajnimit në punë, të krijojnë rrjete, të kryejnë praktikën shkollore dhe për studentët e huaj ofron mundësinë e eksperiencës në një mjedis kulturor të ndryshëm.

Mbështetësit dhe Bashkëpunëtorët

Ne u jemi mirënjohës të gjithë mbështetësve dhe bashkëpunëtorëve të cilët besuan në kapacitetin dhe profesionalizmin e Partnerëve duke kontribuar në përpjekjet tona të përbashkëta.

Kjo mbështetje ka qenë jetike për suksesin e Partnerëve-Shqipëri në fuqizimin e kapaciteteve lokale dhe në dhënien e kontributit për demokratizimin e jetës publike në Shqipëri.

PSH është zhvilluar në një organizatë lokale profesionale në fushën e ndërtimit të kapaciteteve institucionale, manaxhimit të burimeve dhe informacionit, hartimit dhe lehtësimit të proceseve, dhe zbatimit të modeleve bashkëpunuese shumëpalëshe.

Në këta dy vjet, mbështetësit kryesorë të Partnerëve-Shqipëri kanë qenë USAID nëpërmjet programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, Projekti i Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë nëpërmjet programit të Rrjetit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Ambasada Britanike dhe Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.

Partnerët-Shqipëri ka bashkëpunuar gjithashtu dhe me donatorë të tjerë, organizata kombëtare e ndërkombëtare si Qendra Olof Palme, Banka Botërore, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Kvinna Till Kvinna, Fondacioni i Partnerëve për Zhvillim Lokal (FPLD), World Learning, IREX Kosovë.

Anekse

Aneks 1. Pasqyrat Financiare

	1 tetor 2006	30 shtator 2007
Fondi USAID	493,550	505,980
Grante të tjera	137,229	177,825
Të ardhura nga shërbimet	88	-
Të ardhura të tjera	4,450	8,953
Interesa bankare	6,927	3,471
Të ardhura nga shkëmbimi	-	16,479
Totali i të ardhurave	642,244	712,708
Grante	71,970	280,708
Trainime	35,094	92,941
Paga	90,497	137,094
Sigurime shoqërore	27,997	21,536
Taksa	-	8,778
Pajisje	-	2,475
Qera	800	-
Telekomunikacion	8,885	9,164
Udhëtim	33,056	21,507
Kancelari	3,685	4,740
Taksa bankare	-	820
Të tjera	-	5,463
Totali i shpenzimeve	271,984.5	585,226.2
Balanca e fondeve	370,260	127,482
Balanca e hapjes	384,407	226,878
Balanca e mbylljes	779,363	354,361

Aneks 1. Pasqyrat Financiare

	1 tetor 2007	30 shtator 2008
Fondi USAID	505,980	142,050
Grante, kontrata	177,825	379,902
Të ardhura të tjera	8,953	8,763
Interesa bankare	3,471	1,206
Të ardhura nga shkëmbimi	16,479	2,349
Totali i të ardhurave	712,708	534,270
Grante	280,708	38,682
Zyra	-	232,231
Trainime, workshope	92,941	106,853
Paga	137,094	129,182
Sigurime shoqërore	21,536	22,303
Taksa	8,778	16,904
Pajisje	2,475	18,399
Utilities	-	2,552
Telekomunikacion	9,164	10,087
Udhëtim	21,507	17,177
Kancelari dhe shpenzime të tjera zyre	4,740	6,192
Taksa bankare	820	1,227
Të tjera	5,463	6,547
Totali i shpenzimeve	585,226.2	608,336
Balanca e fondeve	127,482	-74,066
Balanca e hapjes	226,878	354,361
Balanca e mbylljes	354,361	280,295

Aneks 2. Burimet e granteve të PSh-së dhe përdorimi i fondeve

GRANTET

Numri i Grantit	Titulli i Grantit	Organizata e Donatorit	Shërbimet dhe Produktet	Vlera e Grantit
Janar – Dhjetor 2007	Olof Palme	Përmirësimi i Qëndrueshmërisë së OJF-ve	26,308 Euro	
Janar – Shkurt 2007	CIDA	Publikimi i Edicionit të 3-të të Adresarit të OJF-ve	2,000 CAD	
Shkurt - Dhjetor 2007	Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë	Trainime në Qeverisje me Pjesëmarrje dhe Teknika të Qeverisjes	58,271 USD	
Janar - Shtator 2007	Fondacioni Partnerët për Zhvillim Lokal (Partnerët-Rumani)	Rritja e Angazhimit të Lidershit Vendor për të Parandaluar dhe Kurrar Korrupsionin në Nivel Vendor	5,000 USD	
Tetor - Nëntor 2007	Fondacioni Partnerët për Zhvillim Lokal (Partnerët-Rumani)	Vlerësim Nevojash dhe Ofrim Trainimi për Bashkinë e Sarandës në "Shkrim dhe Manaxhim Projektesh"	3,800 USD	
Janar - Shtator 2008	Fondacioni Partnerët për Zhvillim Lokal (Partnerët-Rumani)	Përhapja dhe Zbatimi i Metodës së Kurimit dhe Parandalimit të Korrupsionit në Qeverisjen Vendore në Shqipëri	5,983 USD	
Qershor - Dhjetor 2008	Ambasada e SHBA Tiranë	Për një Qeverisje Vendore më të Përgjegjshme dhe Transparente	18,900 USD	
Prill 2008 - Mars 2009	Ambasada Britanike Tiranë	Të Punojmë së Bashku për një Qeverisje Vendore më të Përgjegjshme dhe Transparente	49,000 GBP	
Shtator 2008 - Mars 2009	Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta Tiranë	Të Punojmë së Bashku për një Qeverisje Vendore më të Përgjegjshme dhe Transparente	2,783,430 Lekë	
Shkurt - Dhjetor 2008	Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë	Trainime në Procedura të Brendshme për OJF-të dhe Mobilizimi i komunitetit në Proceset Elektorale	66,609 usd	

Bashkëpunëtorë të tjerë

Numri i Grantit	Titulli i Grantit	Organizata e Donatorit	Shërbimet dhe Produktet	Vlera e Grantit
Janar 2007	Unë, Gruaja	Përmirësimi i Procedurave të Brendshme të Shoqatës "Unë, Gruaja"		
Shkurt 2007	Rromani Baxt Shqipëri	Ngritje Kapacitetesh të Organizates		
Shkurt-Mars 2007	World Learning	Konsulencë për Qëndrueshmërinë		
Prill-Qershor 2007	Banka Botërore	Trainim për grupin Zëri i Rihisë së Shqipërisë		
Prill 2007	Shoqata e Grave me Probleme Sociale	Trainim në Aftësitë Komunikuese		
Korrik 2007	World Vision Shqipëri	Përgatitje Moduli dhe Ofrim Trainimi		
Maj – Nëntor 2007	UNDP	Raport progresi mbi zbatimin e Strategjisë së Romëve në Shqipëri		
Korrik 2007-Shkurt 2008	IREX	Trainim për ATRC		

Bashkëpunëtorë të tjerë

Janar 2008	Partnerët-Jordani	Trainime në Qeverisjen e Mirë: Lufta Kundër Korrupsionit, Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje
Shkurt 2008	Partnerët-Jordani	Trainime në Qeverisjen e Mirë: Pjesëmarrja Qytetare në Jetën Politike, Mjetet për Mobilizimin Efektiv të Komunitetit
Prill-Qershor 2008	Kvina Tili Kvina	Trainim në Qëndrueshmëri
Dhjetor 2007	Chemonics International INC. Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë	Trainime në "Kujdesi për Klientin" për Punonjës të QKR, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrës së Avokatit të Prokurimeve
Shkurt-Korrik 2008	Chemonics International INC. Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë	Monitorimi i Performancës së QKR-së në Ofrimin e Shërbimeve
Mars-Maj 2008	Chemonics International INC. Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë	Vlerësim i Kapaciteteve të Stafit të Zyrës së Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Zyrës së Tatimpaguesve të Tiranës
Shkurt-Prill 2008	Chemonics International INC. Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë	Organizim Trainimi dhe Tryezash të rumbullakta me Operatorë Ekonomikë
Prill-Korrik 2008	Chemonics International INC. Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë	Organizim Workshopeh Informative mbi Prokurimin Elektronik
Qershor Korrik 2008	Chemonics International INC. Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë	Organizim Trainimesh TOT për Punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Aneks 3. Përfituesit e Programit të Granteve të Vogla

RAUNDI I KATERT

OJF-ja përfituese	Titulli i Projektit	Buxheti i projektit
Shoqata për Kulturë Demokratike	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	24,730 usd
Shoqata për Kulturë Demokratike, Elbasan	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	10,780 usd
Instituti Shqiptar për Sistemin e Zgjedhjeve	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	21,101 usd
KRIIK- Shqipëri	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	21,672 usd
Gruaja për Veprim Global	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	19,551 usd
Për Gratë dhe Fëmijët, Qendra Kombinat	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	19,286 usd
Këshilli Rinor Shqiptar	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	16,686 usd
Lëvizja "MJAFT"	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	17,738 usd
Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	4,457 usd
Agjencia për Drejtimin e Zgjedhjeve	Monitorimi i Zgjedhjeve Vendore 18 Shkurt 2007	1,754 usd
Shoqata për Kulturë Demokratike	Monitorimi i Zgjedhjeve të Pjeshme Parlamentare për Zonën 26	1,760 usd
Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit (KSHKK)	KSHKK kontribon për një qeverisje më të mirë në Shqipëri	9,081 usd
Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi	Monitorimi i Mediave gjatë procesit të Zgjedhjeve Vendore 2007	23,205 usd
Shoqata për Kulturë Demokratike	Monitorimi i procesit të balotazhit në 22 njësi të pushtetit vendor në kuadër të Zgjedhjeve Vendore 2007	4,685 usd

RAUNDI I PESTE

OJF-ja përfituese	Titulli i Projektit	Buxheti i projektit
Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit	KSHKK Kontribon në Qeverisjen e Mirë në Shqipëri	11,052 USD
Shoqata në Mbështetje të Grave me Probleme Sociale	Ngritja e një zyre për çështjet e grave në bashkinë e Durrësit	4,985 USD
Fondacioni “Zhvillimi dhe Monitorimi i Infrastrukturës, Mjedisit dhe Shoqërisë Civile”, Gjirokastër	Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në bërjen e politikave-forma të reja të qeverisjes së mirë për zhvillimet vendore në Shqipëri	4,955 USD
Gruaja Intelktuale Pogradec	Monitorimi i performancës së stafit të Bashkisë	4,775 USD
Unë, Gruaja!, Pogradec	Opinionin ynë rreth investimeve të Bashkisë	4,508 USD
Qendra rinore, Vlorë	Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrjen lokale	4,120 USD
Qendra Rinore “Epoka e re”, Fier	Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrjen lokale	4,120 USD
Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Korçë	Inkurajimi i dialogut sektor publik-sektor privat si një mjet për të luftuar korrupsionin dhe përmirësuar ambjentin e biznesit	4,946 USD
Forumi Rajonal i OJF-ve në Krujë	Ku jemi me zbatimin e premtiveve të bëra gjatë fushatës lokale?	4,380 USD
Ndryshim	Një Kartë Raportuese për qytetarët e Vlorës	2,050 USD
Mendoni për Ne	Së bashku për qeverisje të mirë	3,215 USD
Në Familje për Familjen	Për një qytet të gjelbër	4,705 USD
Forumi i pavarur i Gruas, Dega Burrel	Qeverisje e mirë me pjesëmarrje qytetare	4,115 USD
Shoqata për Mbrojtjen e Tregëtarëve dhe të Tregut	Përmirësimi i efektivitetit të shoqërisë civile në përmirësimin e rolit të tyre watchdog dhe monitorues.	4,987 USD
Shoqata për Kulturë Demokratike	Monitorimi i zgjedhjeve të pjesshme parlamentare për zonën 31	2,260 USD